



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

Tiranë, më 21.1.2020

R A P O R T

PËR AKTIN NORMATIV NR.34, DATË 16.12.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.88/2019, “PËR BUXHETIN E VITIT 2020”, TË NDRYSHUAR”

I. Hyrje.

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në cilësinë e Komisionit përgjegjës, në mbledhjen e datës 21 janar 2021, shqyrtoi aktin normativ nr.34, datë 16.12.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për disa ndryshime në ligjin nr.88/2019 “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar. Akti normativ u shqyrta sipas rregullave të parashikuara në nenet 32-38 të Rregullores së Kuvendit.

Komisioni caktoi relator, për këtë akt normativ, z. Anastas Angjeli.

Në mbledhjen e Komisionit ishin të ftuar Znj, Adela Xhemali – Zëvendësministre e Financave dhe Ekonomisë, si dhe znj. Mimoza Dhëmbi – Drejtore e Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit në këtë ministri.

II. Baza ligjore.

Akti normativ nr.34, datë 16.12.2020 është paraqitur për miratim, nga Këshilli i Ministrave, mbështetur në bazën kushtetuese e ligjore, si më poshtë:

- nenet 101 dhe 160 të Kushtetutës;
- nenin 46 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;
- rregullat e përcaktuara në kreun III të pjesës së dytë të Rregullores së Kuvendit.

III. Zhvillimet kryesore ekonomike gjatë vitit 2020.

Gjatë vitit 2020 ekonomia e vendit vuajti dy goditje: tërmetin e datës 26 nëntor 2019 dhe pandeminë shëndetësore globale COVID-19. Goditjet nga pandemia patën efekt më të gjatë dhe vijnë të rëndojnë ekonominë e vendit. Si rrjedhojë e këtyre dy goditjeve, ekonomia e vendit u tkurr gjatë vitit 2020.

Për të përballuar efektet shëndetësore të pandemisë, u miratuan një sërë masash sociale, përmes ligjeve, akteve normative apo vendimeve të Këshillit të Ministrave, të cilat u orientuan kryesisht drejt izolimit social, pezullimit të lëvizjes së lirë të qytetarëve dhe ndërprerjes së veprimtarisë në disa biznese. Këto fenomene sollën shkurtimin e vendeve të punës në disa biznese, si dhe reduktimin e kërkesës për mallra e shërbime dhe të eksporteve.

Masat e ndërmarra u orientuan drejt mbështetjes ndaj shtresave më vulnerabël, personave të larguar nga puna dhe veprimtarisë së disa bizneseve. Përmes akteve normative dhe vendimeve të Këshillit të Ministrave, u miratuan dy paketa financiare për mbështetjen sociale ndaj qytetarëve dhe bizneseve; u rrit buxheti për sektorët e shëndetësisë dhe mbrojtjes, si dhe u rrit fondi rezervë i Këshillit të Ministrave për të përballuar shpenzime të tjera të nevojshme dhe të paparashikuara.

Paketat financiare mundësuan arritjen e disa masave mbështetëse, si:

Paketa e parë mundësoi mbështetje për biznesin e vogël dhe qytetarët, përmes ndihmës financiare në vlerën 26 mijë lekë në muaj për të punësuarit në subjektet e biznesit me të ardhura vjetore deri 14 milionë lekë, për periudhën pas ndërprerjes së aktivitetit ekonomik. Gjithashtu, ajo mundësoi edhe dyfishimin e pagesës për personat që përfitojnë ndihmë ekonomike dhe pagesë papunësie.

Paketa e dytë siguroi mbështetje për sipërmarrjen dhe punëmarrësit, përmes subvencionit në vlerën 40 mijë lekë për punonjësit e larguar nga puna dhe punonjësit e bizneseve të mbyllura me urdhër të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale; subvencionit për punonjësit e bizneseve me të ardhura nën 14 milionë lekë, subvencionit të pagës së luftës për punonjësit e strukturave akomoduese në sektorin e turizmit; mbështetjes për punonjësit e Rafinerisë së Ballshit; ndihmës financiare për aplikuesit e ndihmës ekonomike.

Politikat e ndjekura gjatë vitit 2020 janë vlerësuar pozitivisht nga institucionet financiare ndërkombëtare. Banka Botërore ka theksuar se këto politika kanë dhënë efekt pozitiv në frenimin e ndikimeve negative të pandemisë. Ajo ka mbështetur politikat për subvencionimin e punonjësve të larguar nga puna, programet e ndihmës sociale, mbështetjen e biznesit etj. Instrumentet e financimit, si skemat e garantimit të kredisë, ndikuan në zhbllokimin e kredive për sipërmarrjet, si dhe mbështetjen e vijimësisë së biznesit dhe punësimit.

IV. Ndryshimet e mëparshme në buxhetin e vitit 2020.

Buxheti i vitit 2020 është ndryshuar më parë me 3 akte normative të Këshillit të Ministrave. Të gjitha aktet normative u miratuan për të zbutur efektet ekonomike e sociale të pandemisë shëndetësore COVID-19, duke siguruar mbështetje për sektorin e shëndetësisë, shtresat në nevojë, personat e larguar nga puna në biznese etj. Këto akte normative janë si më poshtë:

Akti normativ nr.6, datë 21.3.2020, i cili reduktoi të ardhurat e përgjithshme të buxhetit me 20 miliardë lekë, duke sjellë rritje të defiçitit buxhetor dhe borxhit publik.

Akti normativ nr.15/2020, datë 15.4.2020, i cili nuk ndryshoi nivelin e të ardhurave dhe shpenzimeve të përgjithshme të buxhetit, si dhe të defiçitit buxhetor. Ky akt normativ mundësoi financimin me 7 miliardë lekë të shpenzimeve në kontingjencën për paketën sociale anti-COVID, duke përdorur si burim rialokimin e shpenzimeve buxhetore. Ai mundësoi edhe mbështetjen për biznesin, në formën e instrumentit të garancisë së re sovrane, në masën 15 miliardë lekë.

Akti normativ nr.28/2020, datë 2.7.2020, i cili reduktoi të ardhurat e përgjithshme të buxhetit me 43 miliardë lekë dhe rriti shpenzimet e përgjithshme të buxhetit me 21 miliardë lekë kundrejt planit fillestar 2020. Kjo solli rritjen e defiçitit buxhetor, i cili u parashikua në nivelin 8.4 për qind të PBB-së, nga 2.2 për qind e PBB-së që ishte sipas buxhetit fillestar. Rritja e shpenzimeve dhe rialokimi i tyre u orientua drejt financimit të investimeve në disa sektorë prioritarë të ekonomisë. Gjithashtu, ky akt normativ mundësoi edhe miratimin e garancisë sovrane në masën 15 miliardë lekë.

V. Qëllimi, arsyet dhe përmbajtja e aktit normativ nr.34, datë 16.12.2020.

Qëllimi i ndryshimeve të propozuara në aktin normativ nr.34, datë 16.12.2020 është mbështetja e disa kategorive sociale më vulnerabël të popullsisë, të goditura nga pandemia COVID-19, siç janë pensionistët dhe personat që përfitojnë ndihmë ekonomike apo pagesë për aftësi të kufizuar, si dhe rialokimi i shpenzimeve, për të siguruar rritjen e efektivitetit të përdorimit të fondeve publike.

Ndryshimi i buxhetit nëpërmjet aktit normativ të fundvitit 2020 u vlerësua i nevojshëm nga Këshilli i Ministrave pas analizës së situatës makroekonomike e fiskale, të kryer në muajin dhjetor. Nga kjo analizë u evidentua nevoja dhe urgjenca për marrjen e disa masave mbështetëse ndaj shtresave me të ardhura më të ulëta. Gjithashtu, u evidentua nevoja për mbështetjen e disa sektorëve të rëndësishëm apo jetikë të ekonomisë, si sektorët e ujësjellës-kanalizimeve, infrastrukturës, sistemit të drejtësisë, pushtetit vendor etj. Në këtë analizë u evidentuan edhe rialokimet e mundshme për të realizuar mbulimin e shtesës së shpenzimeve buxhetore.

Akti normativ nr.34, datë 16.12.2020 është akti i katërt që ndryshon buxhetin e vitit 2020. Ndryshimet buxhetore të parashikuara prej tij janë si më poshtë:

Së pari, akti normativ nuk ndryshon parametrat kyç makroekonomikë e fiskalë, siç janë defiçiti buxhetor dhe borxhi publik.

Së dyti, akti normativ parashikon disa rialokime në shpenzimet korrente dhe kapitale, si më poshtë:

Shpenzimet korrente:

- a) Alokohen 3.4 miliardë lekë për financimin e shpërblimit të fundvitit për pensionistët (5 mijë lekë për çdo pesonist). Ky shpërblim do të përballohet nga:
 - ✓ 1.7 miliardë lekë nga rritja e kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore;
 - ✓ 1.7 miliardë lekë nga fondet e ISSH, të parashikuara në buxhetin 2020.
- b) Shtohen 1.4 miliardë lekë në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, kryesisht për financimin e ndihmës ekonomike dhe të paaftësisë së kufizuar në kushtet e pandemisë COVID-19.
- c) Shtohen 420 milionë lekë për subvencionimin e ndërmarrjeve të ujësjellës-kanalizimeve, të cilat do të përdoren për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura në:
 - ✓ Kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore 300 milionë lekë;
 - ✓ Tatimin mbi fitimin 120 milionë lekë. Ky fond përbën 20 për qind të stokut të detyrimeve të prapambetura në tatimin mbi fitimin.

Fondi për subvencione prej 420 milionë lekësh ka një efekt neutral në buxhetin e vitit 2020, pasi do të shkojë automatikisht për pagesën e detyrimeve si më lart, duke u regjistruar si hyrje apo të ardhura në buxhetin e vitit 2020.

ç) Shtohen fondet në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Eergjisë, në vlerat si më poshtë:

- ✓ 200 milionë lekë për financimin e përpunimit të mbetjeve urbane;
- ✓ 9.4 milionë lekë është kundërvlera e 75 mijë eurove, për pagesën e studios së konsulentëve ligjorë në procesin e arbitrazhit ndërkombëtar për çështjen TIA.

Shpenzimet kapitale.

- Shtohen 2.9 miliardë lekë për financimin e sektorit të ujësjellës-kanalizimeve në shkallë vendi, për përmirësimin e furnizimit me ujë të popullsisë;
- Shtohen 982 milionë lekë për projektet e përpunimit të mbetjeve urbane;

- Shtohen 673 milionë lekë për dy projekte prioritare të KQZ: “Projektin e identifikimit elektronik të zgjedhësve” dhe “Projektin pilot të votimit dhe numërimit elektronik”;
- Alokohet fondi prej 200 milionë lekësh për shpenzime shpronësimi dhe shlyerje detyrimesh të prapambetura në sektorin e infrastrukturës;
- Alokohet fondi shtesë prej 100 milionë lekësh në programin e kërkimit shkencor për Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë;
- Akordohet fondi prej 97 milionë lekësh për ngritjen e sistemeve mbështetëse për funksionimin e godinës së SPAK-ut dhe BKH-së.

Financat vendore.

Në buxhetin e pushtetit vendor bëhen këto ndryshime:

Së pari, shtohen 70 milionë lekë në transfertën e pakushtëzuar, e cila detajohet dhe u shtohet disa njësi të vetëqeverisjes vendore. Kjo shtesë bëhet për arsye se pushteti vendor, ashtu si ai qendror, gjatë periudhës së pandemisë COVID-19, ka hasur problematika në mbledhjen e të ardhurave, duke sjellë vështirësi në likuidimin e shpenzimeve.

Së dyti, shtohen 200 milionë lekë në planin e taksave të ndara, me qëllim mbulimin e plotë të fondit që u takon njësi të vetëqeverisjes vendore në formën e taksës së ndarë nga tatimi mbi të ardhurat personale. Kjo për arsye se sipas ligjit për financat e vetëqeverisjes vendore, njësitë e vetëqeverisjes vendore marrin 2 për qind të të ardhurave nga tatimi mbi të ardhurat personale të realizuara në territorin e tyre. Pjesa tjetër e këtyre të ardhurave derdhet në buxhetin e shtetit.

Së treti, reduktohen me 470 milionë lekë shpenzimet me financim të huaj. Ky ndryshim bëhet për arsye se nga 1 miliardë lekë që janë planifikuar për këtë zë, realizimi është vetëm 200 milionë lekë. Fondet e reduktuara do të përdoren në sektorë të tjerë, me qëllim rritjen e efikasitetit të përdorimit të parave publike.

VI. Miratimi i ndryshimeve me akt normativ.

Prej vitesh është bërë praktikë që ndryshimet në buxhetin vjetor të bëhen me akt normativ të Këshillit të Ministrave. Kjo praktikë mbështetet në nenin 101 të kushtetutës, i cili përcakton si kërkesa për nxjerrjen e aktit normativ ekzistencën e disa kushteve, si nevojën, urgjencën dhe përkohshmërinë e masave të propozuara, si dhe detyrimin për miratimin e aktit normativ nga Kuvendi brenda 45 ditëve.

Në rastin konkret, ndryshimet janë të nevojshme dhe urgjente, pasi synojnë të financojnë shpërblimin e fundvitit për pensionistët, si dhe realizimin e objektivit për dyfishimin e pagesës

së ndihmës ekonomike dhe aftësisë së kufizuar. Ky akt normativ duhet të miratohet nga Kuvendi brenda datës 30 janar 2021.

Paraqitja e ndryshimeve buxhetore me akt normativ është shqyrtuar, ndër vite, edhe nga Gjykata Kyshtetuese. Në vendimet nr.24, datë 10.11.2006 dhe nr.23, datë 16.4.2014, kjo Gjykatë është shprehur se ndryshimet buxhetore mund të paraqiten me akt normativ të Këshillit të Ministrave në rastet kur plotësohen kërkesat kushtetuese përkatëse.

Gjithashtu, ndryshimi i buxhetit me akt normativ të Këshillit të Ministrave është në përputhje edhe me ligjin për menaxhimin e sistemit buxhetor, i cili parashikon që në rast se miratimi i ndryshimeve nuk bëhet brenda muajit korrik, propozimi për ndryshimin e ligjit të buxhetit vjetor votohet me procedurë të përshpejtuar.

VII. Diskutimi në Komision.

Znj. Adela Xhemali, Zëvendësministre e Financave dhe znj. Mimoza Dhëmbi, Drejtore e Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit në këtë ministri, paraqitën aktin normativ dhe iu përgjigjën pyetjeve të deputetëve.

Relatori paraqiti opinionin e tij zhvillimin e ekonomisë gjatë vitit 2020 dhe ndryshimet e parashikuara në aktin normativ. Ai theksoi se, si rrjedhojë e dy goditjeve, tërmetit të datës 26 nëntor 2019 dhe pandemisë shëndetësore COVID-19, ekonomia e vendit u tkurr gjatë vitit 2020. Kjo tkurrje u shpreh përmes treguesve kryesorë, të realizuar përafërsisht si më poshtë:

- Rritja ekonomike ishte negative, - 4.4 për qind;
- Deficiti buxhetor 6.7 për qind;
- Borxhi publik 79.9 për qind.

Më tej, relatori theksoi se ndryshimet buxhetore, të bëra me aktin normativ në fund të vitit 2020, ishin mjaft të nevojshme dhe me efekte pozitive. Këto ndryshime krijuan mundësinë për dhënien e shpërblimit për pensionistët në fund të vitit dhe për financimin e skemës së ndihmës ekonomike e aftësisë së kufizuar. Gjithashtu, ato krijuan hapësirat e nevojshme për përballimin e situatës së pandemisë shëndetësore, rialokimin e investimeve drejt projekteve me ecuri të mirë dhe mbështetjen e pushtetit vendor. Këto rialokime mundësojnë përdorimin me efektivitet të fondeve buxhetore të vitit 2020.

Gjatë diskutimit shumica e deputetëve i mbështeti ndryshimet e propozuara në aktin normativ.

VIII. Përfundim.

Mbështetur në argumentet si më lart, Komisioni e miratoi aktin normativ nr.34, datë 16.12.2020, të Këshillit të Ministrave, me shumicë votash.

KRYETARI

Anastas ANGJELI